



► PËRMIRËSIMI I KUALITETIT TË JETESËS1

► PËRZGJEDHJA E MARRJES SË GRANTIT: GARANTIMI I TRANSPARENCËS1

► PAMJE E RE PËR LAGJEN ALI IBRA.....2

► TË DREJTAT E GJUHËVE: PARAKUSHT PËR INTEGRIMIN E PLOTË NË SHOQËRI2



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit – Kancelaria e Premijera – Office of the Prime Minister
Zyra për Çështje të Komuniteteve / Kancelaria za pitanje zajednica / Office for Community Affairs

Nr. 2 | Qershor | 2010

Fuqia në diversitet

PËRMIRËSIMI I KUALITETIT TË JETESËS

ZÇK ndanë 10,709.00 euro për ndërtimin e kanalizimit në komunën e Lipjanit

Gatehmëria e Qeverisë së Kosovës për të ndihmuar ndërtimin e infrastrukturës, kësaj radhe u orientua në Komunën e Lipjanit, ku u nënshkrua marrëveshja trepalëshe për bashkëfinancim të projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit dhe asfaltimin e rrugës në lagjen “Haxhi Kleçka” të kësaj komune. Bazuar në marrëveshje, ZÇK dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim financojnë ndërtimin e sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza, ndërkaq komuna e Lipjanit do të asfaltojë rrugën. Kjo dëshmon edhe njëherë bashkëpunimin e mirëfilltë ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale, dhe është shembull tipik që pasqyron përpjekjet e qeverisë për t’iu dal në ndihmë qytetarëve varësisht nga nevojat. Nga ky projekt përfitojnë mbi 15 familje të komunitetit serb dhe shqiptar, të cilat aktualisht ballafaqohen me ujërat fekale në lagjen e tyre. Realizimi i këtij projekti është investim që do të parandalojë derdhjen e ujërave fekale, por njëkohësisht edhe do të mënjanojë ndotjen e mjedisit. Vlera e përgjithshme e projektit arrin në 20,709 euro.



PËRZGJEDHJA E MARRJES SË GRANTIT: GARANTIMI I TRANSPARENCËS DHE PËRGJEGJSHMËRISË

Komiteti vlerësues i drejtuar nga ZÇK, vlerëson kualitetin dhe rëndësinë e projekteve të paraqitura

Në mars të vitit 2010, ZÇK ka lansuar dy ftesa për propozime, për OJQ dhe komuna, respektivisht për projektet që kontribuojnë në implementimin e të drejtave të komuniteteve dhe adresimin e nevojave të tyre. Komisioni pesë anëtarësh i përbërë nga ekspertë të institucioneve lokale dhe organizatave ndërkombëtare, i emëruar me vendim të Sekretarit të Përhershëm në Zyren e Kryeministrit, pas një vlerësimi dhe pune intensive, bëri përzgjedhjen e përfituesve të grantit.

Më shumë se njëqind projekte të paraqitura u vlerësuan në bazë të një sërë kriteresh të përcaktuara në thirrjet për propozim, dhe në përputhje me mandatin dhe objektivat e ZÇK-së. Më pastaj u miratua një listë përfundimtare e projekteve me vendim me konsensus të komisionit. Objektivat e këtyre projekteve janë: promovimi i kulturës,



qasja në arsim dhe shërbime shëndetësore, bashkëpunimi midis grupeve të ndryshme sociale, apo çështjet specifike të cilat ballafaqohen të rinjtë dhe gratë nga komunitetet.

Për shkak të kufizimit të fondeve, ZÇK aktualisht është në kërkim të bashkë-financuesve në mënyrë që të krijojë mundësi për realizimin e të gjitha iniciativave të zgjedhura, të cilat përfaqësojnë një vlerë të shtuar të konsiderueshme për komunitetet e Kosovës. OSBE-ja tashmë është angazhuar për financimin e tri prej këtyre projekteve. Vendimi përfundimtar do të publikohet përmes faqes zyrtare dhe medieve.

PAMJE E RE PËR LAGJEN ALI IBRA

Institucionet e Kosovës reagojnë ndaj kushteve të tmerrshme me të cilat ballafaqohen banorët e lagjes Ali Ibra në komunën e Gjakovës



Ali Ibra është një prej vendbanimeve joformale të Kosovës e cila është e vendosur në pjesën Jug-Lindore të komunës së Gjakovës. Kjo lagje ekziston që nga viti 1960. 140 familje të kësaj lagje kryesisht egjiptian, por gjithashtu edhe shqiptar, rom, ashkali dhe serb, aktualisht ballafaqohen me probleme të strehimit dhe kushte ekonomike shumë të rënda.

Bazuar nga një vlerësim të bërë nga Caritas-i i Zvicrës dhe nga një proces gjithëpërfshirës konsultimi me banorët e lagjes Ali Ibra dhe autoritetet komunale, zhvendosja është identifikuar si zgjidhja më e kapshme dhe e qëndrueshme. Projekti gjithëpërfshirës, objektivi i të cilit nuk është vetëm për t'u siguruar banorëve të kësaj lagje kushte adekuate të jetesës, përmes ndërtimit të shtëpive dhe të infrastrukturës, por edhe për t'i pajisur ata me mundësi më të mira të të ardhurave, si dhe të ndihmojë integrimin

e plotë në aktivitetet e ndërtimit të komunitetit. Ndërsa, në të ardhmen është projektuar edhe qasja e tyre në arsim dhe në shërbime shëndetësore në nivel komunal.

Komuna e Gjakovës ka ndarë një gastër të tokës, për këtë projekt me vlerë rreth 3.5 milion euro. Caritas-i i Zvicran dhe Komuna e Gjakovës u bashkuan shumë shpejt nga ana e institucioneve qendrore-ZÇK dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, si dhe Zyra Zvicerane për bashkëpunim, në një partneritet unik duke punuar drejt një realiteti të ri. ZÇK beson që ky projekt do të jetë një shembull pozitiv i kontributit në implementimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe bënë thirrje për mbështetje të mëtejshme financiare.



TË DREJTAT E GJUHËVE: PARAKUSHT PËR INTEGRIMIN E PLOTË NË SHOQËRI

Fillimi i studimit të dytë të politikave dedikuar përdorimit të gjuhëve

Përdorimi i gjuhëve është çështje kritike për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë. Gjuha është element thelbësor i kulturës dhe identitetit të komuniteteve, dhe për këtë arsye luan një rol të madh në ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Përdorimi i gjuhëve ndikon në disa aspekte të jetës së komuniteteve, të tilla si: liria e shprehjes, arsimi, informimi, mundësitë ekonomike etj.

Politikat gjuhësore në Kosovë bazohen në dy objektiva themelore: në ndërtimin e një shoqërie shumë-etnike dhe ruajtjen e identitetit dhe të kulturës së të gjitha komuniteteve. Politikat gjuhësore përfshijnë njohjen e gjuhës shqipe dhe serbe, si dhe alfabetet e tyre si gjuhë zyrtare të Kosovës në baza të barabarta, duke përfshirë të drejtën e barabartë në përdorimin e tyre dhe në të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike dhe në sistemin gjyqësor, si dhe të drejtën e arsimimit dhe informacionit në këto gjuhë. Për më tepër objektivat e grupit të

politikave janë njohja e këtyre gjuhëve si gjuhë zyrtare në nivel komunal. Përveç kësaj, nxënësit dhe studentët gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, kanë të drejtë të arsimohen në nivel të ulët dhe të mesëm shkollor.

Implementimi i kësaj kornize politike gjithëpërfshirëse, duke reflektuar standardet më të larta ndërkombëtare, mbetet një detyrë jo e lehtë për institucionet e Kosovës. ZÇK mbështetur nga projekti ECMI të financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës, do të bëjë një vlerësim mbi zbatimin e këtyre politikave, duke u përqendruar në përdorimin e gjuhëve në institucionet dhe ndërmarrjet që kryejnë shërbime publike, si dhe në zonat e kufizuara të sferës private. Do të zhvillohet një grup i rekomandimeve bazuar në gjetjet, në mënyrë për të siguruar që politikat e gjuhës t'i përmbushin objektivat e tyre.

Ky projekt është një zgjidhje e problemit për banorët e kësaj lagje, e cila vazhdon të ballafaqohet me ujëra të zeza dhe ndotjen e ambientit.